

Bisedë me fëmijët

Shoqërimi i fëmijëve gjatë mësimit të gjuhës – nga fillimi

Informacione për prindërit dhe kujdestarët ligjorë



Bisedë me fëmijët

Përse është kaq e rëndësishme gjuha?

Gjuha është e nevojshme kudo për fëmijët: në shtëpi, në rrugë, në grupin e lojës ose në çerdhe si dhe më vonë në kopsht dhe në shkollë. Në jetesën e përbashkët, në shprehjen e ndjenjave, mendimeve, gjatë lojës dhe mësimit - gjuha është gjithmonë thelbësore. Shoqërojeni fëmijën tuaj gjatë mësimit të gjuhës, që në fillimet e tyre!

Çfarë mund të bëni?



Flisni në përditshmëri **shumë** me fëmijën tuaj.



Lëreni fëmijën tuaj të luajë me **fëmijë të tjerë**. Mundësojini fëmijës sa më shumë kontakte me fëmijë dhe të rritur gjermanishtfolës.



Dëgjojeni fëmijën tuaj dhe përpiquni që **ta kuptoni saktë**.



Bëni **biseda** interesante me fëmijën tuaj: Ndani me ta përvojat, tregojuni histori, shpjegojuni botën.



Shoqërojeni fëmijën tuaj në botën e **mediave**. Zbulojni librat, televizionin, smartfonin dhe internetin së bashku.



Flisni me fëmijën tuaj në **gjuhën tuaj**. Në këtë mënyrë bisedat tuaja do të jenë më të gjalla dhe të pasura. Kur në shtëpi fliten disa gjuhë, fëmija vetëm përfiton nga kjo.

A keni pyetje? Këta specialistë do t'ju ndihmojnë më tej

- Këshillimi për nënat dhe baballarët në komunën tuaj
- Mjekja ose mjeku i fëmijës suaj
- Grupet e lojës ose drejtuesit e çerdes

Ku të gjeni shembuj dhe informacione të mëtejshme?

Informacionet për prindërit dhe kujdestarët ligjorë si dhe këtë broshurë e gjeni në gjuhë të ndryshme në: elternwissen-tg.ch/sprich-mit-mir

Filma me biseda të përditshmërisë me fëmijët: kinder-4.ch

